



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR 2022

22.06.2023

Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, së bashku me komisionerët, z. Maksim Shuli, z. Petraq Lika dhe znj. Erjola Sadushi, prezantuan në datën 20.06.2023, për Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Raportin Vjetor të ecurisë së sektorit të energjise elektrike dhe gazit natyror dhe të veprimtarisë së ERE për vitin 2022, i cili paraqet një përshkrim të detajuar si dhe të dhëna specifike mbi ecurinë e sektorëve, duke pasqyruar në mënyrë krahasimore treguesit e këtij viti me vitet parardhës.

Z.Ahmeti në mënyrë të përmbledhur pasqyroi ndër të tjera të dhënat në rritje të prodhimit të energjisë elektrike, uljen e konsumit të energjisë elektrike si pasojë e fushatave sensibilizuese krahasuar me një vit më parë, humbjet në sistemin e shpërndarjes apo dhe detaje mbi raportimet e arkëtimeve dhe faturimeve të shoqërive publike; por dhe arritjet, vështirësitë apo dhe sfidat me të cilat ky sektor është përballur gjatë vitit që u la pas, duke theksuar që 2022-shi ishte një vit mjaft i vështirë qoftë në sektorin energjistik dhe atë të gazit natyror, sidomos nga faktorë si lufta në Ukrainë që solli një rritje qoftë të çmimit të gazit natyror deri në 400% por dhe të energjisë elektrike në të gjithë Europën dhe Rajonin që çuan në nevojën për disa hapa strategjik në përputhje me Ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Ndër masat e marra z. Ahmeti rikujtoi për anëtarët e komisionit ndër të tjera vendosjen e gjendjes së jashtzakonshme të furnizimit me energji elektrike, alokimin e fondeve dhe mbështetjen nga buxheti i shtetit për përballimin e çmimeve të importit të energjisë elektrike për sigurimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve; vendosjen e detyrimit të shërbimit publik të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike; vendosjen e detyrimit për kompaninë publike të gjenerimit KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve nga operatorët e rrjetit, për të parandaluar efektin financiar të blerjes së kësaj energjie me çmimet e larta të importit; optimizimin e burimeve hidrike nga prodhuesit e pavarur nëpërmjet kontratave të depozitimit midis operatorit publik të ngarkuar me këte shërbim dhe KESH sh.a.; krijimin e kushteve ligjore për sigurimin e kapaciteteve

gjeneruese nga ana e kompanisë publike KESH sh.a. nëpërmjet marrjes me qera të njësisve gjeneruese të reja apo dhe mundësive për depozitimin e energjisë elektrike me operatorët privat; vendosjen e kontributit për solidaritetin gjatë kohëzgjatjes së krizës energjitike, për prodhuesit e energjisë elektrike që të tregtojnë me çmim të liberalizuar të cilët patën të ardhura të shtuara si efekt i rritjes së çmimeve të shitjes së energjisë elektrike në treg të lirë.

Këto masa, theksoi kryetari, garantuan furnizimin e pandërprerë me energji elektrike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pa kosto shtesë për konsumatorin tarifor, duke qënë që Shqipëria është ndër të paktat vende që mbajti të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike në tregun e rregulluar.

Miratimi i rregullave të tregut dhe licencimi i operatorit të burses së energjisë elektrike ALPEX sh.a., është reflektuar gjithashtu në raport si një risi e vendimmarjes së Entit Rregullator të Energjisë.

Bordi ju përgjigj pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, mbi çështje të tilla si prodhuesit me përparësi, detaje mbi faturimin e Inceneratorit të Elbasanit, Gazsjellësin Albgaz, Tec-in e Vlorës, pyetje rreth funksionimit të kontratave të FSHU sh.a. apo dhe situatës aktuale me Prodhuesit e Bukës dhe çmimit të energjisë elektrike për këta të fundit, me qëllim sqarimin, por duke qëndruar gjithmonë brenda kompetencave të institucionit.

Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë për Vitin 2022 do të prezantohet gjithashtu në vazhdim dhe në Kuvendin e Shqipërisë në Seancë Plenare në vijim.